



SYNETI DHE BIDATI



ROLI I THIRRJES CIVILIZUESE
TË PEJGAMBERËVE TË ZOTIT
NË SHOQËRINË NJERËZORE



PARIMET TONA

Viti XIV - Nr. 4 (158),
Prill, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

NE JEMI MUSLIMANË DHE JEMI KRENARË QË JEMI MUSLIMANË!



“E kam studiuar historinë e feve për 50 vite dhe di të them se besimi (akideja) me të cilin edukohen muslimanët nxit vërtetë habi të madhe! Ai ngrihet mbi besimin se njeriut nuk mund t’i ndodhë asgjë, përveç asaj që është shkruar nga All-llahu dhe se askush nuk mund ta ndryshojë këtë besim a ta tejkalojë atë! Islami është feja, që të gjithë do ta pranojmë, herët a vonë! Mua nuk më vjen keq të thuhet për mua se jam musliman!”

(Johann Wolfgang von Goethe)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut, Zotit të vetëm të botëve, Poseduesit të gjithçkaje, Krijuesit Fuqiplotë, Furnizuesit, Atij që kur dëshiron diçka urdhëron: “Bëhu” dhe ajo bëhet!

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë të begatë dhe në çdo ditë të jetës tonë, më të dashurit tonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), atij që do t’i prijë njerëzimit me flamurin e falënderimit ndaj All-llahut, drejt xhenneteve të Tij, në jetën e përtejme!

TË DASHUR VËLLEZËR, TË NDERUARA MOTRA,

Sot, në këtë ditë të parë të Muajit të begatë Rexheb të vitit 1437, me rastin e hyrjes në atmosferën e Tre Muajve të Mirë; Rexheb, Shaban dhe Ramazan, dua t’ju uroj me zemër dhe t’ju përgëzoj, ju dhe veten time, që Zoti i gjithësisë na e dha edhe një herë mundësinë e përjetimit të kësaj mirësie të madhe, në të cilën përfshihemi të gjithë ne dhe bota mbarë, në këtë periudhë të shtrenjtë të vitit.

Sot, të gjithë ne kemi nevojë për të rishikuar marrëdhënien tonë me Zotin e gjithësisë, me Krijuesin e vetëm të galaktikave, të tanësisë, All-llahun e Madhëruar.

Ditët dhe netët e kësaj periudhe tremujore, janë një mundësi më shumë, që secili prej nesh të rishikojë në thellësinë e zemrës së tij, për të gjetur mirësitë e besimit, si dhe për të llogaritur gabimet e një viti që shkoi.

NE JEMI MUSLIMANË DHE JEMI KRENARË QË JEMI MUSLIMANË!

Ne si muslimanë jemi të ftuar sot, të zbulojmë më të mirën e udhëzimit hyjnor në veten tonë, ta përhapim me sa të kemi mundësi në realitetet e hirta të shoqërisë së sotme shqiptare, që përkthejnë qartazi mosbesim dhe devijim nga busulla e udhëzimit hyjnor.

Sepse, Shqipëria jonë e shtrenjtë, ka më shumë se kurrë nevojë sot, për Islamin dhe muslimanët, për mësimet e Kur’anit dhe Traditat e Hz. Muhammedit (a.s), për kontributin tuaj, për ndihmën tuaj, për shpirtin tuaj, për mirësinë dhe dritën tuaj!

Shqipëria jonë e shtrenjtë lëngon sot, nga mungesa e moralit islam në realitet e saj, nga përpjekjet për t’ia ndryshuar me çdo kusht identitetin e saj të besimit dhe nënshtrimit para vullnetit dhe udhëzimit të Zotit të vetëm të gjithësisë! Vendi ynë, që e kemi amanet të shenjtë, na thërret, o muslimanë!

Shqipëria jonë e shtrenjtë sot, lëngon përhapjen e shthurjes, krimin në familje, drogën dhe bimët narkotike, alkoolin dhe imoralitetin, përpjekjet për ta bërë të bardhën të zezë dhe të zezën të bardhë, edhe nga foltoret e tribunave më të larta të kombit, korrupsionin dhe padrejtësitë, shkeljen e pronës legjitime dhe nëpërkëmbjen e pronarëve të rregullt, përhapjen e divorceve për shkak të tradhëtisë bashkëshortore, abortet për shkak të lidhjeve ilegjitime, humbjen e kohës dhe vrasjen e shpresës, sidomos tek rinia jonë, abuzimin me tekstet shkollore dhe edukimin e mbrapshtë të fëmijëve tanë, laicizmin e neveritshëm selektiv dhe nëpërkëmbjen e të drejtave të muslimanëve dhe muslimaneve praktikante, veçmas!

Shqipëria jonë e shtrenjtë ju thërret, o muslimanë, o bij të kësaj toke të bekuar, o besnikë të Fjalës së All-llahut, o pasues të bindur të Mësimeve të Hz. Muhammedit (a.s)!

Mos t’ia kthejmë shpinën hakut të Shqipërisë sonë ndaj nesh, mos t’ia

kthejmë shpinën urdhëresave hyjnore për ta ndërtuar tokën, për ta zhvilluar jetën, për të ndërtuar ura komunikimi të sinqerta me vëllezërit tanë të kësaj vendlindjeje të përbashkët, për të kontribuar pa kursim për zhvillimin e Thirrjes së Shenjtë Islame në këtë vend dhe përtej kufijve të tij!

TË DASHUR E TË SHTRENJTË VËLLEZËR DHE MOTRA BESIMTARË,

Sot është koha, që secili prej nesh të ngrihet e të mos bëhet palë me të keqen, t’ia mbyllë dyert shejtanit dhe të mos bëhet aleat i tij, sepse ai është armik i hapur i racës njerëzore;

*SEPSE, SHQIPËRIA
JONË E SHTRENJTË,
KA MË SHUMË SE KURRË
NEVOJË SOT, PËR ISLAMIN
DHE MUSLIMANËT,
PËR MËSIMET E KUR’ANIT
DHE TRADITAT
E HZ. MUHAMMEDIT (A.S),
PËR KONTRIBUTIN TUAJ,
PËR NDIHMËN TUAJ, PËR
SHPIRTIN TUAJ,
PËR MIRËSINË
DHE DRITËN TUAJ!*

urdhëron për skamje, për shthurje, për mosbesim, për pabesi e dinakëri, për abuzim me vlerat e tolerancës dhe shkelje të rregullave të harmonisë, për shirk dhe idhujtari, për kopraci dhe dembelizëm, për abuzim me kohën dhe mbytjen e saj pa asnjë dobi, për përçarjen në mesin e antarëve të familjes së madhe të besimit, për

denigrimin e prijësve tanë fetarë në sytë e vetë besimtarëve, që të mbeten si bashkësi pa prijës, për mosbindjen ndaj All-llahut dhe mospasimin e traditave dhe mësimeve të Hz. Muhammedit (a.s) dhe të dërguarve të Zotit, për shumë e shumë!

Prandaj të përgatitemi me forcën e besimit, krenarinë e tij dhe bindjen ndaj All-llahut të Madhëruar, në përballjen tonë me të keqen dhe partizanët e saj!

Kësisoj, këdo që të shihni se po kryhen me besnikëri mësimet dhe udhëzimet e shejtanit, konsiderojeni shejtan, prej të cilit duhet distancuar dhe me të cilët duhet t'i ndajmë rrugët tona!

Ne jemi muslimanë, nuk jemi të droguar! Ne jemi muslimanë, nuk jemi të alkoolizuar! Ne jemi muslimanë, nuk jemi imoralë! Ne jemi muslimanë, nuk gënjejmë! Ne jemi muslimanë, nuk i bëjmë shirk All-llahut, duke iu përrulur a nënshtruar dikujt tjetër pos Tij! Ne jemi muslimanë, mbjellim kudo paqe dhe mëshirë! Ne jemi muslimanë, duart tona janë të shtrira ndaj kujtqdo që dëshiron me sinqeritet dhe dinjitet të ndërtojë vlerat e harmonisë dhe tolerancës ndërfaqetare! Ne jemi muslimanë, e vlerësojmë kohën dhe e kemi aleat të fuqishëm në rrugëtimet tona drejt shkencave dhe thellimit në dije e përparim! Ne jemi muslimanë, jemi të pastër, jemi të paqtë, jemi bujarë e bëmërës, jemi një familje e madhe, ku të gjithë janë vëllezër dhe, ku secili dëshiron për tjetrin atë që dëshiron për veten e tij! Ne jemi muslimanë dhe jemi krenarë që jemi muslimanë!

TË DASHURIT E MI,

Këto ditë dhe netë janë ditët dhe netët e Teuhidit, janë thirrje të përbotshme, që njerëzimi të zgjohet nga koma e idhujtarisë, nga preket vrastare të shirkut, që është përhapur në masë, nga haramet, që kanë përfshirë kudo shoqërinë tonë, sidomos alkooli, shthurja e grave, hutimi i rinisë, neglizhenca ndaj adhurimeve dhe kopracia për të bërë mirë!

Le të pendohemi e të kërkojmë falje para duarve të Zotit të gjithësisë, të na pastrojë zemrat, të na udhëzojë

*Ne jemi muslimanë, nuk
jemi të droguar!
Ne jemi muslimanë,
nuk jemi të alkoolizuar! Ne
jemi muslimanë,
nuk jemi imoralë!
Ne jemi muslimanë, nuk
gënjejmë!
Ne jemi muslimanë,
nuk i bëjmë shirk All-llahut,
duke iu përrulur a nënshtruar
dikujt tjetër pos Tij!
Ne jemi muslimanë,
mbjellim kudo paqe
dhe mëshirë!
Ne jemi muslimanë,
duart tona janë të shtrira
ndaj kujtqdo që dëshiron
me sinqeritet dhe dinjitet
të ndërtojë vlerat
e harmonisë
dhe tolerancës ndërfaqetare!*

mendjen e mendimet, të na dritësojë rrugët e jetës, të na dhurojë durimin dhe ndjesinë e përgjegjësisë për të jetuar me krenari si muslimanë të përkushtuar, krenarë me identitetin islam, krenarë me çdo ajet të Kur'anit Famëlartë, krenarë me udhëzimet dhe mësimet e Hz. Muhammedit (a.s), krenarë me historinë e lavdishme të ymetit islam ndër shekuj, krenarë për historinë tonë të lavdishme si shqiptarë, kur për mbi pesë shekuj drejtuam botën dhe përhapëm kudo Dritën e besimit dhe udhëzimin e pastër në Një Zot, tolerancën ndaj jomuslimanëve, mëshirën ndaj krijesave të Zotit, në periudhën e artë të hilafetit osman, ku ne ishim prijës krenarë!

Le të shfrytëzojmë ditët dhe netët e kësaj periudhe tremujore për t'u kthyer te krenaria e jonë, te besimi ynë, te Islami ynë, te Kur'ani që na bashkon, te thirrjet dhe lutjet e pejgamberit tonë (a.s), që na donte të bashkuar, në unitet, në harmoni, në

vëllazëri, dorë për dorë duke ndërtuar vlera, dorë për dorë duke mbjellur paqe dhe siguri, dorë për dorë duke dhuruar mëshirë dhe bujari, dorë për dorë duke investuar për një të ardhme më të garantuar për fëmijët tanë, Shkodrën dhe Shqipërinë tonë të shtrenjtë!

MOTRA TË NDERUARA DHE JU VËLLEZËR TË SHTRENTJË,

Tre Muajt e Mirë, që nisin sot, janë mundësi e madhe për të rregulluar ekuilibrat e identitetit dhe ndërgjegjes në jetë! Janë një mundësi e artë, që muslimani të paqtohet me vëllezërit e tij, të shtojë aktivitetin bëmërës, të rregullojë marrëdhëniet familjare e fafësnore, të kontrollojë edukimin e fëmijëve të tij, të urdhërojë kudo për të mirë dhe të ndalojë të keqen, me sa të ketë mundësi!

Këta Tre Muaj, janë një mirësi e madhe nga Zoti i gjithësisë, që na fton drejt mëshirës dhe bujarisë së Tij për të rregulluar secili prej nesh marrëdhënien e tij me Krijuesin e vet, në fshehtësinë e tij dhe në marrëdhënie me krijesat e Zotit; prandaj mos e humbni kohën me debate shterpë e pëshpërma qoshkesh, mos e humbni kohën, sepse çdo ditë e çdo natë e kësaj periudhe është Ditë e Mirë e Natë e Mirë, ku adhurohet All-llahu i Madhëruar dhe afrohet drejt Mëshirës dhe dashnisë së Tij me vepra të mira, me rregullimin e njetit, me kufizimin e fjalëve, me mostejkalimin e caqeve të etikës dhe edukatës islame në jetë!

Të dashur e të shtrenjtë besimtarë,

Sot, teksa dilni nga xhamia, pas faljes së namazit të kësaj xhumaje të begatë dhe lutjeve të këtij tubimi, urone njëri-tjetrit, shtrëngoni duart e dhuroni buzëqeshje në fytyrën e njëri-tjetrit, përhapjen e vëllai-vëllanë e motra-motrën, që All-llahu i Madhëruar na e mundësoi sërish të jemi pjesë e kësaj mrekullie të përvitshme besimi që quhet; Tre Muajt e Mirë!

Ju dua për hir të All-llahut dhe lutem për ju, edhe ju luteni për mua!

Vel-hamdulil-lahi rabbil-alemin!

*(Hytbe e mbajtur
në xhaminë e Parrucës)
Shkodër, më 8 prill 2016*



Sheikh Muhamed El-Gazali

Ekzistojnë zhurma të larta rreth sjelljeve seksuale të popullsisë së globit, e unë në emër të Islamit dhe ndoshta në emër të feve qiellore mbarë, po paraqes këto parime, si rregulla të konferencës¹, që do të trajtojë ecurinë e këtyre sjelljeve të tronditura:

1- Njeriu është pronar i trupit dhe është prej të drejtës së tij të bëjë me të çfarë të dojë, ashtu siç thonë shumica e laikëve, por ne ju kujtojmë se Allahu është Pronari i Parë i Vërtetë i këtij trupi, sepse Ai është Krijuesi i tij, Kujdestari i kësaj çështjeje, Burimi i legjislationit, i cili i bën dobi, e lartëson dhe e pastron, e nuk pranojmë absolutisht asnjë debat në këtë të drejtë.

2- Shtrati bashkëshortor është i vetmi takim i pranueshëm mes burrit dhe gruas, e përveç kësaj është mëkat. Marrëdhëniet intime janë mbështetje e shtëpisë së ndershme dhe edukim moral për çfarë dhuron Allahu prej fëmijëve. Martesa me motivet e

1. Bëhet fjalë për Konferencën e Popullsisë së Botës, e mbajtur në Kajro në vitin 1994.

PARIMET TONA

UNË NË EMËR TË ISLAMIT DHE NDOShTA NË EMËR TË FEVE QIELLORE MBARË,
PO PARAQES KËTO PARIME, SI RREGULLA TË KONFERENCËS,
QË DO TË TRAJTOJË ECURINË E KËTYRE SJELLJEVE TË TRONDITURA

dilirësisë dhe me përkujdesjen ndaj trashëgimit të jetës është adhurim (ibadet) prej adhurimeve më të pastra, kështu që duhet të krijohen kushte lehtësuese dhe të largohet çdo pengesë përpara saj.

3- Prostitucioni, homoseksualizmi, lezbizmi dhe të gjitha fëlliqësitë epshore janë ndalesa të refuzuara. Legjitimiteti i tyre është luftë ndaj Zotit, zullum ndaj natyrës së origjinës dhe shkatërrim për shoqërinë.

4- Lejohet për rrethana të veçanta largimi ndaj periudhave të shtatzënisë dhe vlerësimi u lihet bashkëshortëve.

5- Origjina e abortit është se ai konsiderohet krim dhe asnjë mjek nuk i drejtohet atij, veçse për të mbrojtur jetën e nënës.

6- Krijuesi i kësaj toke ka vendosur në të aq sa të ushqejë banorët e saj.. mbi bazën e bashkëpunimit të forcave për punimin e tokës dhe nxjerrjen e begative të saj. Dhe, kjo tokë mund të ushqejë shumëfishin e banorëve të saj prezentë, me kusht që të ndalet mëkati e armiqësia dhe të bashkëpunojë njerëzia në mirësi e devotshmëri.

7- Kur shejtani ia arriti të ndezë luftërat, u shkatërruan qytete e fshatra dhe u ngurtësuan miliona e miliarda për armët e shkatërrimi në masë, ndërkohë që ishte e mundshme parandalimi i urisë, sikur këto fuqi të shkonin për ushqyerjen e të uriturve.

8- Konferenca e Popullsisë, e cila u mbajt në Kajro nuk solli asnjë fjalë të vetme për ndalimin e devijimeve dhe luftimin e ligjeve, të cilat i rregullojnë këto, por madje doli nga trajtimet e tyre të gjata e të lodhshme, se ajo pranon lirinë seksuale në kufijtë e ndalimit të rrezikut!

Nëse mbrohen prej sëmundjes së AIDS-it dhe të ngjashmeve me të, atëherë nuk ka kufij për këtë liri të ulët! Ashtu siç u duk qartë dëshira e tyre për pakësimin e banorëve të botës së tretë dhe sigurimi i nivelit të lartë të jetesës për botën e parë, e cila sundon sot globin.

9- Konferenca e lartpërmendur nuk i ngriti sytë nga qielli asnjë ditë, a thua nuk e njeh Zotin e qiellit? Por, ne si myslimanë besojmë në Zotin e tokës dhe të qiellit, e respektojmë Shpalljen e Tij, të cilën e trashëgoi Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhammedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta. E, nëse të tjerët e tradhetojnë fenë e tyre, ne do të qëndrojmë duke i thënë Zotit tonë: “Dëgjua dhe u bindëm. Faljen Tënde (kërkojmë) o Zoti ynë dhe tek Ti është përfundimi!”²

*Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:*

Lavdrim Hamja

2. Kur’ani, El-Bekare: 285.

NE SI MYSLIMANË BESOJMË NË ZOTIN E TOKËS
DHE TË QIELLIT, E RESPEKTOJMË SHPALLJEN
E TIJ, TË CILËN E TRASHËGOI NUHU, IBRAHIMI,
MUSAI, ISAI DHE MUHAMMEDI, PAQJA
DHE SHPËTIMI I ALLAHUT QOFTË MBI TA.





Dr. Mervan Shejkhulerd

Sado që të arrijë madhështia e burrave në jetën njerëzore, gjatë gjithë historisë, e vërteta e institucionit të thirrjes civilizuese të popujve, në origjinë kthehet tek ajo, me të cilën erdhën të Dërguarit e Zotit (paqja e Allahut qoftë mbi ta). Ata janë prijësit udhëzues, të sinqertët e zgjedhur, të cilët punuan në kumtimin e asaj çfarë iu zbrit nga Zoti. Rezultati i punës të tyre të madhe ishte në atë pozitë, sa që Allahu e bëri përvojën e tyre dhe vuajtjet, sinqeritetin dhe qëllimin e tyre të pastër ndaj Allahut, zhveshjen prej çdo interesi personal, përkushtimin e tyre ndaj të vërtetës dhe të drejtës, angazhimin e tyre me detyrat e ngarkuara, në përgëzime dhe në tërheqjen e vëmendjes, shembuj të përkryer dhe shembuj të mirë për të Dërguarin e Allahut, Muhammedin (a.s), vulën e profecisë, me të cilin, Allahu plotësoi fenë dhe plotësoi begatitë. Allahu i Madhërishëm thotë: “Ata (të dërguarit e përmendur) ishin që All-llahu i vuri në rrugë të drejtë, andaj ti merri shembull në udhëzim. Thuaj: “Unë nuk kërkoj për këtë (komunikimin e Kur’anit) shpërblym prej jush. Ky nuk është tjetër, përveç një këshillë për mbarë njerëzit”. (El En’am: 90)

Asnjë prej njerëzve të mençur, nuk duhet anashkalojë, përvojën e Ademit (a.s) dhe të Havasë (a.s), sepse ata të dy janë origjina e gjithë njerëzimit përgjatë gjithë historisë deri në ditën e kiametit. Prandaj, më lejoni që t’ju paraqes serinë e përvojave të Pejgamberëve të Zotit (a.s) që përmes tyre njohim më mirë të dërguarin tonë (a.s) dhe rolin e thirrjes civilizuese, që nguliti fort bazat e tij në institucionin e shoqërisë njerëzore, duke u nisur nga thënia e Pejgamberit tonë (a.s): “Shembulli im dhe shembulli i të dërguarve të tjerë para meje është sikur shembulli i një njeriu, i cili ndërtoi

ROLI I THIRRJES CIVILIZUESE TË PEJGAMBERËVE TË ZOTIT NË SHOQËRINË NJERËZORE

një shtëpi, e komplotoi dhe e zbukuroi, përveç një tulle të vogël. Njerëzit erdhën ta vizitojnë këtë shtëpi e mahniteshin, ndërkohë thonin: Ah, sikur ta plotësoje edhe këtë tullë! Unë jam ajo tullë dhe unë jam vula e Pejgamberëve!” (Transmeton Buhariu)

Njohjen më të madhe të rolit të të Dërguarëve të Zotit, në institucionin e thirrjes civilizuese të shoqërisë njerëzore e gjejmë të qartë, të dukshme, të plotë dhe të kompletuar në ajetin e sures “El-Hadid”: “Ne i dërguam të dërguarit Tonë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës. Ne e kemi zbritur edhe hekurin që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz, e edhe për t’u ditur te All-llahu se kush ndihmon Atë (rrugën e Tij) dhe të dërguarit e Tij duke i besuar të fshehtës. S’ka dyshim se All-llahu është furnizues, mbizotërues.” (El-Hadid: 25)

Ky ajet përmban lidhjen e fortë mes thirrjes në Zot dhe besimit në Njëshmërinë e Tij, dhe mes bazave të ndërtimit të civilizimit njerëzor. Sepse në këndvështrimet e thirrjes:

1- Allahu (xh.sh) dërgoi të Dërguarit për krijesat e Tij, ku secili prej tyre barte me vete argumentet e qarta mbi Njëshmërinë e Zotit dhe i dërgoi ata për të përcjellë mesazhet e Zotit të tyre.

2- Allahu (xh.sh) zbriti me ta diturinë, sheriatin, dispozitat, të vërtetat e krijesave dhe gjallesave, rregullat e kohës dhe aktivitetit të jetës, fillimin dhe mbarimin, xhennetin dhe xhehenemin, besimin dhe veprën e mirë, luftën mes të mirës dhe të keqes, e gjitha kjo në një libër të qartë, pa asnjë dyshim në të e pa asnjë paqartësi, me gjuhën e popullit. Ky libër qartësoi shtigjet e rrugës së drejtë, që të çojnë drejt kënaqësisë së Zotit dhe xhennetit, e përgëzoi vepruesit me të me fitore dhe sukses. Ndau rrugët e humbjes, rrugët e mashtrimit e të shthurjes dhe paralajmëroi jobesimtarët për përfundimin e sjelljeve të humbura ndaj tyre dhe ndaj shoqërisë, dhe se përfundimi që i pret është dëshpërimi në këtë botë dhe dënimi i madh në botën tjetër.

“Shembulli im dhe shembulli i të dërguarve të tjerë para meje është sikur shembulli i një njeriu, i cili ndërtoi një shtëpi, e komplotoi dhe e zbukuroi, përveç një tulle të vogël. Njerëzit erdhën ta vizitojnë këtë shtëpi e u mahniteshin, ndërkohë thonin: Ah, sikur ta plotësoje edhe këtë tullë! Unë jam ajo tullë dhe unë jam vula e Pejgamberëve!”

3- Allahu (xh.sh) zbriti me të Dërguarit e Tij peshoren, me të cilën njerëzit mund të dallojnë përmes saj të mirën dhe të keqen, besimin dhe mosbesimin, udhëzimin dhe humbjen, veprën e mirë dhe veprën e keqe. E gjitha kjo në dijen e Kur’anit, të virtyteve, dispozitave dhe shariatit, të cilat të gjitha kanë për qëllim vendosjen e drejtësisë dhe lirisë, barazisë dhe nderimit të qenies njerëzore, shfrytëzimit të universit dhe kërkimit të vazhdueshëm të të vërtetave e përfitimit prej përvojave jetësore dhe shoqërore në të gjitha aspektet e jetës. Kjo peshore formon pjesën e parë të bazave të jetës dhe ndërtimit të civilizimit njerëzor.

4- Allahu (xh.sh) zbriti hekurin, për të qenë mjet ndërtimi, fabrikimi dhe fuqi që mbron individin dhe shoqërinë. I garanton sigurinë, përparimin dhe lulëzimin. Ky hekur formon një simbol të vërtetë për mineralet dhe kjo do të thotë pjesa e dytë e bazave të jetës dhe ndërtimit të civilizimit njerëzor.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Ervil Kuçi



Shejkh Vehbi S. Gavoçi

SYNETI DHE BIDATI¹

Fjala Synet në fjalor shpjegohet si rrugë e mbaruar ose një veprim i kryer, i mirë apo i lig të jetë dhe më tepër përdoret për një rrugë o veprim të mirë.

Fjala Bidat në fjalor shpjegohet si send i shpikur për herë të parë, i mirë apo i lig të jetë dhe më tepër përdoret për shpikje të papëlqyera.

Për këto dy fjalë nuk kemi pasur nevojë për të shkruar, bile edhe për t'i përmendur në këtë kohë që po bëhen hapa të mëdhenj e të shpejtë për t'u kthyer në mësimin e fesë Islame, në zbatimin e kërkesave të saj, në këtë vend ku u luftua aq rreptësisht feja.

Mirëpo, siç po shihni, ca djem të rinj po i dëgjojnë këto dy fjalë nga disa arabë, që kanë ardhur për të ndihmuar dhe nga disa të rinj shqiptarë që po studiojnë në vendet arabe.

Pikërisht për këtë duhet të shkruajmë për këto dy fjalë që rinia të mos harrojë rrugën e madhe e të ndritshme, që kanë vazhduar hoxhallarët, këtu e në vende të tjera të botës islame.

Për këtë arsye po përsëris shtypjen e këtij libri si dritë në rrugën e madhe me pishtarë të njohur që në kohë të Profetit (a.s) dhe pas tij, që rinia të mësojë e të vazhdojë në këtë rrugë me mendje të plotë, me zemër të pastër e me shpirt të qetë.

Mëshira e mbrojtja e Zotit (xh.sh) qofshin për herë me ne.

ÇFARË ËSHTË SYNETI E BIDATI?

Disa djelmosha që kanë shkruar për të studiuar për fenë Islame në disa vende

1.Ky material është marrë nga libri i dijetarit shkollor Shejkh Vehbi S. Gavoçi: NJOHURI RRETH KUR'ANIT – SYNETI E BIDATI, Shkodër, 1999.

SYNETI DHE BIDATI

arabe dhe disa arabë që janë dërguar në Shqipëri për të ndihmuar fenë tonë, kanë sjellë me vete fjalën *Bidat* dhe këtë fjalë e përsërisin herë mbas here.

Prandaj, po shkruaj në këtë libër të vogël disa fjalë në lidhje me bidatin, megjithëse nuk e shohim të pëlqyeshme me e marrë këtë fjalë, veçanërisht prej rinisë që edhe sot ecë këmba-doras në dije të gjuhës arabe e në dije të fesë Islame.

Fjala *bidat* arabisht d.m.th. gjë e shpikur, pa shembuj të mëparshëm, në fe. Gjë e shpikur, pa shembull të saktë, por që bazohet në pëlqimin e fesë ose bashkëpunon me opinionin e saj. Ajo, edhe në qoftë se është e shpikur pa shembull të veçantë, pranohet e quhet *BIDAT* i pranuar e i pëlqyer përndryshe është e ndaluar. Ja disa shembuj:

1) U përfundua zbritja e Kur'anit dhe vdiq Profeti (a.s). Hz. Omeri dhe Hz. Ebu Bekri menduan se mos po pakësohen ata njerëz që e dinë Kur'anin përmendësh dhe menduan se kështu ndoshta do të humbasë ndonjë pjesë nga Kur'ani dhe menduan që ta mbledhin atë në një libër.

Thirrën Zejdin, djalin e Thabitit, shkruesin e Kur'anit me urdhër të Profetit (a.s) dhe para tij. Ai porsa dëgjoji propozimin e tyre tha se po bëni një gjë që nuk e ka bërë Profeti (a.s), d.m.th. se po shpikni.

Ata iu përgjigjën se kjo është një punë e mirë me të cilën mbrohet Kur'ani nga humbja. Zejdi atëherë pranoi dhe u mbledh Kur'ani prej një grupi dijetarësh, ku kryetar ishte Zejdi dhe kujdestarë për këtë punë ishin Hz. Omeri dhe Abdull-llahi, djali i Mes'udit.

Ajo shpikje që ka të bëjë me mbrojtjen e Kur'anit nga humbja ose ndryshimi, gjë që e thotë edhe vetë Kur'ani, pra nuk quhet gjë tjetër vetëm se shpikje e mirë, ose *bidat* i pëlqyer.

2) Ndërroi jetë Profeti (a.s) pa lënë zëvendës pas tij. U mbledhën sahabët për të zgjedhur një drejtues në çështjet e fesë dhe menduan për Ebu Bekrin për të udhëhequr e drejtuar popullin siç e ka udhëhequr e drejtuar Profeti (a.s). Kjo që një shpikje, për ruajtjen e qeverisë

e të popullit, që të jetonte i sigurt e i bashkuar, pra kjo quhet shpikje e mirë ose bidat i pëlqyer.

3) Në vitin 100 të emigrimit Omeri, djali i Abdyl Azizit kërkoi zyrtarisht prej disa dijetarëve të njohur të vendeve të ndryshme, që të regjistronë Hadithet e Profetit (a.s) në vendet e tyre që të mos humbë Hadithi e të shkojë dija. Ne dimë se shumë pak Hadithe janë regjistruar në kohë të Profetit (a.s), sepse ai e ndaloi për disa kohe regjistrimin e Hadithit, me qëllim që të mos përzihej me Kur'anin. Kjo shpikje e Hz. Umerit

DISA DJELMOSHA
QË KANË SHKUAR
PËR TË STUDIUAR PËR
FENË ISLAME NË DISA
VENDE ARABE
DHE DISA ARABË QË JANË
DËRGUAR NË SHQIPËRI
PËR TË NDIHMUAR
FENË TONË,
KANË SJELLË ME VETE
FJALËN BIDAT DHE KËTË
FJALË E PËRSËRISIN
HERË MBAS HERE.

quhet shpikje e mirë mbasi kjo ka të bëjë me mbrojtjen e Hadithit, mbrojtjen e dijes.

4) Në vitin 80 Kalifi Abdyl Melik urdhëroi me e nda Kur'anin në 30 pjesë që të lexohet për çdo muaj krejt Kur'ani dhe urdhëroi për të dalluar disa germa të caktuara duke i vendosur pika. P.sh. germës "b" i vuri një pikë poshtë, germës "t" dy pika lart, disa germa të ndara i lidhi në shkrimin e Kur'anit. Kjo njihet si një shpikje e mirë, mbasi ndihmon leximin e Kur'anit, si i është zbritur zemrës e veshit të Profetit (a.s).

5) Profeti (a.s) fali teravinë në Ramazan për tri ditë rresht pa na caktuar në sa reقات është falur. Në natën e katërt nuk doli me falë teravinë, e të nesërmen iu tha sahabëve: “Kam qenë zgjuar, por nuk dola me u falë që teravia të mos bëhet detyrim për ju, si jacijsa”.

Në atë kohë, sahabët e falnin teravinë grupe-grupe. Në kohë të Kalifit Omer kjo gjë ndryshoi. I pau të ndarë sahabet grupe-grupe dhe vendosi t'i bashkojë në një grup, në teravi, si në faljet e detyruara, ku vuri një prijës (imam) për burrat e një tjetër për gratë, e kjo gjë u pranua prej sahabëve. I bashkoi me u falë 8 reقات të gjata, kur pau se po mërzhiten njerëzit, atëherë e bëri teravinë me 20 reقات më të shkurta. Vazhdoi ky synet në kohën e tij e më mbrapa e deri më sot që falet teravia 20 reقات, në Mekë, Medine, e në të gjitha vendet Islame.

Puna e Hz. Umerit edhe pse qe shpikje, ajo quhet *bidat i pëlqyer*, mbasi ka lidhje me rregullimin e faljes, për të caktuar prijësin e numrin e reقاتëve.

6) Dijetarët mbas sahabëve, kanë shkruar disa libra për jetën e Profetit (a.s). Kanë bërë disa libra për komentimin e Kur'anit të bekuar, për Akaid e besim, siç ka bërë Ebu Hanifja librin në Fikh, në një rregull që vetë ai e ka shpikur dhe që është pasuar me rregullat e Hadithit e librave që janë shkruar për gjuhë e lëndë të tjera. Të gjitha këto janë të shpikura, mirëpo mbasi kanë të bëjnë me ruajtjen e dijes e të fesë, për t'i shtuar dhe përhapur, ato quhen *shpikje të pëlqyeshme*, mbasi feja na kërkon të mësojmë ç'ka na duhet.

7) Po ashtu thuhet për librat që kanë sqaruar doktrinat fetare të ndryshme jashtë Islamit dhe për librat që janë shkruar për disa grupe fetare si havarihet, që thonë se Zoti (xh.sh) është trup etj. mbasi shkruhen për ta ruajtur fenë e pastër e për ta pastruar atë nga ato njolla që përpiqet dikush t'ia mveshë fesë, si po mundohen sot Kadianija, Behaija e disa sekte Batinijë.

8) Janë hapur shkolla e konvikte me rroga për studentët, janë ndarë dijet në grupe të ndryshme etj.

9) Janë lënë Vakfet në degë të ndryshme për Ulema e studentë, jo vetëm për libra e lexime të Kur'anit, Hadithit, Fik'hut, për mësimin e disa librave ose temave të caktuara, por

edhe për të vobektit, të këputurit nga vendet e tyre, për jetimët e të vejat e deri për kafshët e pa zot, ose të përzëna. Të gjitha këto mbasi bashkohen me mbrojtjen e fesë, mësimin e saj dhe shtimin e dijes janë quajtur *shpikje të pëlqyera*.

10) Kur vdiq Profeti (a.s), vetëm 14 njerëz në kohën e tij, që iu përgjigjeshin pyetjeve të njerëzve. Mbas tij, në kohën e sahabëve, arritën deri në 140, siç thonë ulematë e tjerë. Mijëra besimtarë i pyetnin ata për çështjet e fesë që kishin nevojë të dinin.

Zoti (xh.sh) në Kur'an të bekuar ka thënë: “Në qoftë se nuk dini, pyetni ata që dinë”.

Më vonë, kur u shkruan librat u caktuan disa njerëz të mirë, që dhanë shumë për dije e mësim në kohën e tyre dhe iu mblodhën disa njerëz si studentë, të cilët morën dijen e mësuesve të tyre, që shkruan edhe ata libra, e kështu u formuan disa shkolla dijeje, të cilat në Fikh janë katër: Ebu Hanifja (Hanefi), Malikiu (Maliki), Shafiu (Shafi), Ahmed, djali i Hanbelit (Hanbeli).

Prej në kohë të vjetra e deri më sot, më shumë se 13 shekuj, shihen këto katër medh-hebe. Ato nuk janë fé as nuk janë pjesë fetare, ata janë vëllezër në një rrugë, kanë studiuar, kanë dëgjuar, kanë marrë nga njëri-tjetri në bazë të parimeve të fesë dhe kanë përhapur dijen e tyre të pëlqyeshme. Ne jemi të detyruar të merremi me medh-heb. Ne këtu në Shqipëri me medh-hebin Hanefi sepse jemi mësuar nga baballarët tanë në këtë medh-heb dhe dijmë se ka fakte të pëlqyeshme për çështjet që përmendëm. Kjo gjë nuk është *bidat*, mbasi vetë Kur'ani thotë, siç e përmendëm edhe më lart: “Në qoftë se nuk dini, pyetni ata që dinë”.

Por, frika është se disa që janë dërguar për të na ndihmuar fetarisht po na kërkojnë dhe mësojnë për t'i pasuar ata, ose disa të rinj të panjohur ose si dijetarë të panjohur prej dijetarëve të njohur, kërkojnë me e lanë medh-hebin tonë, e në këtë mënyrë nuk kanë shqetësim për grisjen e përçarjen që mund të shkaktojnë në vendin tonë, në një kohë që kemi më tepër nevojë të mësojmë parimet e fesë, të bashkohemi e të duhemi për hir të saj, të bashkëpunojmë e t'i mësojmë fenë e parimet e saj këtij populli, shumë prej të cilëve nuk e dinë as Shehadetin, as Elhamin.



*"E habitshme është puna jonë,
e ne myslimanëve.. adhurojmë
një Zot të Vetëm..
sillemi (bëjmë taraf)
rreth një Qabeje të vetme..
drejtohem në namazin tonë
nga një Kible e vetme..
rreshtohemi në xhami
në një rresht (saf) të vetëm..
dhe themi të gjithë "Amin"
me një zë të vetëm..
e megjithatë secili prej nesh
ka Islam të veçantë, që ndryshon
prej Islamit të tjetrit..
dhe secili prej nesh
e kupton Islamin sipas mënyrës
së tij dhe e praktikon
në jetën e vet
sipas kuptimit të tij të veçantë."*

Dr. Mustafa Mahmud

“MUA NUK MË VJEN KEQ TË THUHET PËR MUA SE JAM MUSLIMAN!”

Mëngjesin e kësaj të xhumaje, vendosa t'i rikthehem leximit të veprës me titull: “Islami në sytë e dijetarëve dhe mendimtarëve objektivë perëndimorë”, të autorit El-Husejni El-Husejni El-Muaddi.

Vepra në gjuhën arabe, botuar në Damask, 2007, ka 328 faqe, ku vihet re se autori është lodhur për të vënë në duart e lexuesit mendime dhe konkluzione intelektuale të personaliteteve të ndryshme të botës, kryesisht në perëndim, në lidhje me fenë islame; madhështinë e tij, praktikitetin, harmoninë e teksteve të shenjta, tolerancën, humanizmin, përshtatshmërinë me zhvillimet e kohës, por jo vetëm.

Në vend të një hytbeje të munguar ditën e sotme, po ndaj me ju disa pjesë, që më tërhoqën t'i përkthej e t'i përshtas në shqip për ju, duke ju uruar njëkohësisht: Xhuma Mubarek!

“Që në orët e tij të para, Islami vërtetoi se është feja e krejt racave, teksa përqafoi Selman Farisiun (pers), Bilal Habeshiun (etiopian) dhe Suhejb Rumiun (romak), duke i shkrirë në një realitet të vetëm” – **Xhorxh Bernard Show**.

“Islami është feja e vetme, që ka arritur të plotësojë kërkesat e trupit dhe të shpirtit njëkohësisht, pa e ekspozuar muslimanin të jetojë në një gjendje vrasjeje të ndërgjegjes! Është feja e vetme, adhurimet e së cilës janë pa imazhe fotografike dhe, kjo është dhurata më e madhe që Krijuesi i ka bërë racës njerëzore!” – **Lamartin**.

“Unë ftoj botën sot, të marrin në konsideratë parimet e vëllazërisë dhe barazisë islame, pasi akideja e teuhidit (besimi në Njësinë) është ndër shembujt më të mrekullueshëm drejt idesë së njësisimit të botës! Prezenca e Islamit është shpresë për mbarë botën!” – **Arnold Toynbee**.

“E kam studiuar historinë e feve për 50 vite dhe di të them se besimi (akideja) me të cilin edukohen muslimanët nxit vërtetë habi të madhe! Ai ngrihet mbi besimin se njeriut nuk mund t'i ndodhë asgjë, përveç asaj që është shkruar nga All-llahu dhe se askush nuk mund ta ndryshojë këtë besim a ta tejkalojë atë! Islami është

feja, që të gjithë do ta pranojnë, herët a vonë! Mua nuk më vjen keq të thuhet për mua se jam musliman!” - **Johann Wolfgang von Goethe**.

“I kam hyrë studimit të Kur'anit pa ndonjë mendim paraprak dhe me objektivizëm, në kërkim të shkallës së përputhshmërisë së tekstit kur'anor me të dhënat e shkencës moderne. Arrita në konkluzionin se nuk ka asnjë thënie të kritikueshme, nga pikëpamja shkencore bashkëkohore...” – **Maurice Bucaille**.

“Bleva një kopje të përkthimit Savary, të Kur'anit, në gjuhën frënge. Është gjëja më e shtrenjtë që kam. Gjatë leximit përjetova një kënaqësi të madhe. Më dukej se rrezet e së vërtetës së përjetshme ndriçonin mbi mua, nga drita e tij e begatë!” – **William Beckard**, shkrimtar anglez i konvertuar në Islam në vitin 1922. I diplomuar në Canterbury College.

“Ka ende shumë gjëra që perëndimi duhet të mësojë nga civilizimi islam, si vështirimi i arabëve (lexo, muslimanëve) i gjërave me tolerancë dhe mos bërja dallim për shkak të fesë, racës a ngjyrës!” – **Lewis Yong**.

“Islami është fé dhe shtet! Ky është sekreti i madhështisë dhe i forcës së tij, si dhe sekreti i përhapjes së tij befasuese në shekullin e 7-të dhe fillimin e shekullit të 8-të.” – **Rozhe Garodi** (Roger Garaudy).

“Pyetja që më ka stresuar përherë është se ne, të krishterët, pretendojmë se Islami është përhapur me tehun e shpatës. Dhe e pyeta veten se, përse atëherë njerëzit e pranojnë Islamin dhe vazhdojnë ta përqafojnë atë, në çdo cep të botës? Përse njerëz nga mbarë bota udhëzohen drejt kësaj feje çdo ditë dhe pa asnjë kërcënim, dhunë a të ngjashme?” – **Beshir Ahmed Shad**, misionar indian.

“Islami është feja që e ka të mundur përballjen me ateizmin dhe valët e shpërbërjes, prej së cilave lëngojnë shoqëritë e industrializuara sot. Islami do të tërheqë shumë prej të diplomuarve të universiteteve, sidomos ata që janë lodhur dhe rënduar nga debatet teologjike.” – Aktorja italiane **Marcella Michelangeli**, e konvertuar në Islam.

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, më 1 prill 2016



*“Ndërgjegjia e sëmure
dhe mendja bosh
nuk kanë asnjë lidhje
me Islamin.*

*Jeta islame ngrihet
mbi mendje*

të ndritur...

ndërkohë

mendjelehtësia

në fenë tonë

është mëkat.”

Shejkh Muhamed El-Gazali



Naim Drijaj

imam - xhamia Parrucë

Fjalës turp në gjuhën arabe i thonë “hajá” dhe rrjedh prej fjalës “hajat” që ka kuptimin jetë, gjallëri. Imam Ibnul-Kajjim thotë: “Përderisa turpi do të ekzistojë tek njeriu dhe shoqëria, për aq kohë do të ketë jetë e gjallëri tek ata”. Fjala turp në Kur’an është përmendur tre herë në suret: El-Bekare, 2/ 26, El-Ahzab, 33/53 dhe El-Kasas, 28/25.

Dijetarët kanë thënë: Turpi është një cilësi fisnike e cila e nxit dhe e motivon njeriun për t’i kryer tri objektiva kryesore:

1. Për të bërë punë të mira.
2. Për t’u shmangur prej veprave të liga.
3. T’ia japë të drejtën që i takon secilit person.

Ebul Hasen El-Maverdi ka thënë se turpi ndahet në tri pjesë:

1. *Turpi prej Allahut*, që nënkupton përfilljen dhe zbatimin e urdhrave të Tij si dhe largimin nga ndalesat e Tij. Grada më e lartë e turpit është turpi prej Zotit. Çdo gjynah që veprojmë, i madh apo i vogël, nga një i ri apo i moshuar, vjen si rezultat i humbjes së ndjenjës së turpit nga Zoti. Kjo ngaqë ne nuk e ndjejmë praninë e Tij dhe nuk e ndjejmë që Ai na shikon.

Imam Ibnul-Kajjim lidhur me turpin ndaj Zotit thotë: “Gëzimi që kreve gjynahun, është më i rëndë te Zoti se sa vetë gjynahu. E qeshura jote duke kryer gjynahun, është më e rëndë te Zoti se vetë gjynahu. Dëshpërimi yt që nuk e kreve dot gjynahun, është më i rëndë te Zoti se vetë gjynahu. Kujdesi që kushton për ta fshehur gjynahun që të mos merret vesh nga njerëzit, pa u shqetësuar fare që Zoti të ka parë, është më i madh se vetë gjynahu. A turpërohesh nga njerëzit dhe nuk turpërohesh nga vetë Zoti?!”

“ÇDO FE E KA NJË MORAL DHE MORALI I ISLAMIT ËSHTË TURPI!”

Pejgamberi (a.s) një ditë u tha disa prej shokëve të tij: “Turpërohuni nga Allahu (xh.sh) ashtu siç e meriton Ai! Ata thanë: O i Dërguari i Allahut ne turpërohemi. Pejgamberi (a.s) përsëri tha: Jo kështu, porse turpërimi i vërtetë ndaj Allahut është ta ruash kokën dhe atë që është në të pra (mendjen, të folurit, shikimin dhe dëgjimin nga harami), barkun dhe atë që mban në të, dhe të përkujtossh vdekjen. Ai i cili dëshiron Ahiretin të braktis kënaqësitë e tepruara të kësaj bote dhe, ai i cili i bën këto është turpëruar nga Allahu (xh.sh) ashtu siç e meriton Ai.”¹

2. *Turpi prej njerëzve*, dhe

3. *Turpin prej vetes*.

Në ditët e sotme është shumë e rëndësishme për ne, që të jemi njerëz të fortë me besimin tonë, të aftë për të kuptuar realitetin në të cilin jetojmë, dhe të punojmë me të gjitha mundësitë tona që mësimet e pastra besimore, me të cilat jemi veshur, të arrijnë në vendin e duhur, që kjo shoqëri, pjesë e së cilës jemi të gjithë, të kthehet nga burimi i mirësisë dhe i mbarësisë, të veshet me besimin e Njësisisë, të zbukurohet me moralin e turpit, të fuqizohet me dituri e urtësi e të jetë shembull në familjen e madhe të shoqërive njerëzore.

Turpi konsiderohet degë e besimit, e kjo është mënyra më e mirë për ta kuptuar peshën e këtij virtyti. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Imani/ Besimi është shtatëdhjetë e ca apo gjashtëdhjetë e ca degë. Më e larta (më e mira) është fjala “La ilahe il-lall-llah/Nuk ka të adhuruar të meritueshëm përvec Allahut”, dhe më e ulëta është largimi i pengesës nga rruga. Ndërkohë, turpi është njëra prej degëve të besimit.”²

Arsyeja pse turpi bën pjesë në besim, është se që të dy nxisin për mirësi të pastër dhe largimin nga çdo ligësi dhe e keqe. Besimi e nxit muslimanin të bëjë vepra të mira dhe t’u largohet gjynaheve. Nga ana tjetër, turpi e nxit atë të mos e lërë pas dore falënderimin dhe detyrat që ka ndaj Zotit, si dhe e ndalon atë nga veprimet e shëmtuara dhe sharjet. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Turpi sjell vetëm mirësi.”³ Në një version tjetër

transmetohet: “Turpi në tërësi është mirësi (hajr).”⁴ Vehb ibn Munebih ka thënë: “Imani është i zhveshur dhe petka e tij është devotshmëria, stolia e tij është turpi, pasuria e tij është nderi”. Turpi për njeriun është si uji për bimën.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Turpi dhe besimi janë së bashku dhe nëse zhduket njëri prej tyre zhduket edhe tjetri”.⁵ Ajo çfarë duhet të interesohemi për të edukuar brezat e rinj të kësaj kohe është edhe ndjesia e turpit, si një pjesë e rëndësishme e moralit islam, i cili buron nga pastërtia e mësimëve kur’anore dhe e traditës profetike.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Çdo fé e ka një moral dhe morali i Islamit është turpi!”⁶. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Ajo çfarë kanë mësuar njerëzit nga profetët e hershëm është: Kur nuk ke turp vepro ç’të duash!”⁷ Ky hadith ka dy kuptime:

1. Mungesa e turpit të bën që të veprosh çdo gjë.

2. Nëse për veprën që po bën nuk të vjen turp nga Zoti, njerëzit dhe vetja jote, kryeje.

Aisheja, (r.a) tregon: “Kam hyrë në shtëpinë ku është varrosur i Dërguari i Allahut (a.s) dhe babai im (Ebu Bekri r.a). Kam hyrë disa herë e pambuluar duke menduar se këtu janë burri dhe babai im. Por, kur aty është varrosur edhe Omeri (r.a), vallahi nuk kam hyrë brenda në të, në qoftë se nuk kam qenë e mbuluar, sepse më vinte turp nga varri i Omerit(r.a).”⁸

Në ditët e sotme na mungon shumë ky virtyt i lartë, i cili është ndjesia e turpit. Kudo që njeriu hedh shikimin e tij, si në familje, në rrugë, në shkollë, në media të shkruara dhe elektronike, në universitete e spitale, si dhe në të gjitha institucionet tona, në përgjithësi, vëren se gjurmët e turpit janë duke humbur ose kanë humbur fare. Për fat të keq tek ne e keqja është bërë e mirë, kurse e mira është bërë e keqe. E gjithë kjo është rezultat i humbjes së turpit.

4. Muslimi.

5. Hakimi, Bejhakui.

6. Ibn Maxhe.

7. Buhariu.

8. Hakimi, (Sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit hadithi është i saktë).



DIJE DHE P



ASTËRTI...





Arben Halluni, teolog

Feja islame si gjithmonë bën apel për të mbështetur të drejtën e për t'u kapur fort pas saj, për të kryer më të mirën e për të treguar kujdes ndaj saj, për të aplikuar çdo gjë që ruan parimet e larta e principet dalluese, sepse ato pa dyshim janë garant i përsosmërisë së njerëzve dhe u japin atyre rolin si mëkëmbës të Zotit në tokë.

Shumë herë dëgjojmë e shohim se njeriu e humbet rrugën e tij të natyrshme dhe devijon prej saj, o nga injoranca ose nga nënshtrimi me dashje ndaj epshit të tij mashtrues, çka e zbret atë nga niveli njerëzor në nivelin më të ulët të zhvillimit e të humbjes. Kështu ai bëhet rob i ledhatimeve mashtruese, i epshit shtazarak, duke humbur dallimin me qeniet jonjerëzore. Ditën që ai vendos botën e materies mbi atë të vlerave dhe të moralit shpirtëror, jeta do t'i kthehet në një konflikt me pasoja, shumë herë më të ashpra e më të frikshme se konflikti i kafshëve mishngrënëse.

Njeriu si qenia më e preferuar e Allahut (xh.sh) duhet të kujtojë se ai nuk është krijuar të jetë melek fisnik e as njeri pa mëkate. Ai është njeri tek i cili konfliktohen forcat e të mirave dhe të këqijave. Nganjëherë mbi njeriun mbisundon natyra e shpirtit të mirë dhe si rrjedhojë vlerësohet e ngjitet në majat e larta të devocionit. Nganjëherë mbi njeriun zotëron natyra e të keqes dhe si pasojë ai kthehet në mishërim të saj. Prandaj është detyrë e rëndësishme e njeriut në këtë jetë sprove që të korrigjojë vazhdimisht gabimet e tij, të shërojë sëmundjet shpirtërore e të pastrojë veten nga çdo e ligë, në mënyrë që të vazhdojë misionin e tij në këtë botë si mëkëmbës i vërtetë i Krijuesit të gjithësisë në tokë, i veshur shpirtërisht me botë të pastër e të dëlirë. Allahu (xh.sh) thotë në Kur'an: "...Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në

PENDIMI!

mënyrë që të gjeni shpëtim" - (En-Nur: 31). Pra, teubeja duhet të bëhet për të gjitha gjynahet të dukshme qofshin apo të padukshme. Profeti Muhamed (a.s) thotë në një hadith të tij: "Çdo bir i Ademit është gabimtar, dhe më i miri prej atyre që bëjnë gabime është ai që pendohet sinqerisht (duke mos u kthyer më te mëkati)".

Teubeja e sinqertë e bën njeriun që në fillim të ndjejë dhimbje shpirtërore, i kultivon në zemrën e tij pendimin, e shtyn të shkulë një herë e përgjithmonë të keqen dhe njëkohësisht e bën më të vendosur që të rivazhdojë jetën e shëndoshë e ta rinovojë atë sipas kriterëve islame. Nëse njeriu ka të drejta të pakryera ndaj robërve të Zotit Fuqplotë ai ua kthen në mënyrë që të çlirohet prej tyre. Kështu Allahu (xh.sh) ia pranon teuben, ia falë gabimin dhe e bën prej njerëzve të devotshëm. Allahu për këtë çështje thotë në Kur'an: "O ju që keni besuar, pendohuni tek Allahu me një pendim të sinqertë..." - (Et-Tahrim: 8). Pra duhet për hir të Allahut pendim i vërtetë, pa ndonjë qëllim tjetër, pendim që do thotë t'ia kthesh vëllaut tënd të besimit dhe të tjerëve, të drejtën e cënuar, të braktisësh i vendosur veprën e ligë dhe të grisësh perden e hipokrizisë midis teje si njeri i krijuar dhe Krijuesit, Allahut (xh.sh). "Ai është që pranon pendimin e robërve të vet dhe shlyen të këqijat dhe e di çka punoni". - (Esh-Shura: 25). Transmetohet nga Enesi, se Profeti Muhammed (a.s) ka thënë: "Allahu i kënaqet teubes së robit të Vet, sikur ai që ka gjetur deven e tij pasi e ka humbur qëllimisht në një tokë shkretëtirë". - (Transmetuar nga Buhariu dhe Muslim). Një citat i tillë profetik do të thotë shtim i kënaqësisë së Krijuesit të gjithësisë ndaj penduesve të sinqertë. Një gjë e tillë konfirmohet me këto fjalë kuranore: "Në të vërtetë Allahu i don penduesit dhe të pastrit".

Nga mëshira e Allahut është se Madhniploti ka hapur portën e shpresës dhe të optimizmit përpara gabimtarëve që gjatë jetës mund të kenë shkelur të drejtat që ka çdo njeri ndaj Zotit të gjithësisë, ndaj vetes, ndaj njerëzve në përgjithësi, ndaj natyrës etj. Kështu ai ka rast të volitshëm në çdo kohë që së pari ta kuptojë gabimin e tij, ta pranojë atë dhe pastaj të zotohet me

Feja islame si gjithmonë bën apel për të mbështetur të drejtën e për t'u kapur fort pas saj, për të kryer më të mirën e për të treguar kujdes ndaj saj, për të aplikuar çdo gjë që ruan parimet e larta e principet dalluese, sepse ato pa dyshim janë garant i përsosmërisë së njerëzve dhe u japin atyre rolin si mëkëmbës të Zotit në tokë.

pendim të drejtë para Allahut (xh.sh) se kurrë nuk do të kthehet më në ciklet e injorancës, fodullëkut e arrogancës. "Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbisni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, por vërtet, Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues" - (Ez-Zumer: 53). Ndërsa në hadithin Kudsi, Allahu (xh.sh) thotë: "O biri i Ademit (o njerëz), përderisa të më thirrni Mua dhe të kërkoni (ndihmë) prej Meje, Unë do t'ju fali për ata që keni kryer (mëkatet) dhe nuk do t'ju quaj për gjynah. O biri i Ademit, po të ishin gjynahet tuaja sa me kap kupën e qiellit dhe nëse do të bëni teube (kërkoni falje) nga Unë do t'ju fali gjynahet tuaja. O njeri, nëse do të vish tek Unë me gjynahe gadi sa madhësia e tokës e nëse do të më drejtoheni (me zemër të pastër) duke kërkuar teube dhe duke mos më bërë ortak, Unë do t'ju jap falje dhe mirësi sa madhësia e asaj çka vepruat".

Në një nga ajetet e lartpërmendura vihet re një prej frazave: "Allahu fal të gjitha mëkatet...". Po e vërtetë, Allahu fal të gjitha mëkatet, por duke përjashtuar ata që i polemizojnë hyjnisë së tij të Plotfuqishme, çka do të thotë të gjithë ithtarët e propaganduesit e feve idhujtare. Kjo faktohet me ajetin vijues: "S'ka dyshim se Allahu nuk falë (mëkatin) t'i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë, besim në shumë zotëra), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do. Kush

i përshkruan Allahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh”. - (En-Nisaë: 48)

Është e padiskutueshme se mirësia e Allahut (xh.sh) mbi robërit e Tij është e madhe, mëshira e Tij është e gjerë, dyert e Tij janë të hapura. Pra, Krijuesi i gjithësisë shtrin dorën e Tij ditën për të falur të ligat e natës dhe shtrin durën e Tij natën për të falur të këqijat e ditës. Një shprehje e tillë gjendet pikërisht nga Ebu Musa El-Ash'ari (r.a) se i dërguari i Allahut ka thënë: “Allahu shtrin dorën e Tij ditën për të falur të ligat e natës dhe shtrin durën e Tij natën për të falur të këqijat e ditës deri kur dielli do të lindë nga perëndimi”.

Shpejtimi për të kërkuar falje, bërja një herë mirë, kthesë rrënjësore me zotim të singertë për të mos u afruar më te mëkati, për t'u kthyer në ndreqjen e gabimit duke punuar për të ndrequr veten, rigjallëruar zemrën dhe ringjallur ndërgjegjen - të gjitha këto janë teube. Transmetohet nga Ebu Seid El-Khudari se i dërguari i Allahut (xh.sh) ka thënë: “Shembulli i besimtarit dhe i besimit është si shembulli i kalit me lakun e tij, i cili mund të shëtisë apo lëvizë një kohë, pastaj përsëri kthehet te laku (litari i tij). Pra edhe besimtari nganjëherë harron-hutohet pastaj kthehet përsëri në gjendjen e tij të natyrshme e normale. Ushqehuni me ushqimin e të devotshmëve dhe ndiqni rrugën e besimtarëve!”

Ata të cilët për një kohë vijnë në mëkatin, pastaj e kuptojnë se gjynahu apo mëkati nuk sjell dobi e as shpëtim, duke ndjerë dhimbje dhe mungesë ngrohtësie shpirtërore, i kthehen jetës së tyre normale, me shpresën se Allahu (xh.sh) do t'ua falë veprimet e gabuara që mund të kenë dëmtuar si veten ashtu edhe të drejtat e të tjerëve. Në lidhje me këtë, në Kur'an thuhet: “Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetes së tyre, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre – e kush i falë mëkatet përveç Allahut? – dhe që duke e ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen). Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe xhenetet nëpër të cilët rrjedhin lumenj e aty do të rrinë përgjithmonë. Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë”. - (Ali Imran: 135-136)

Duhet të kuptohet mirë se teubeja nuk do të thotë vetëm shqiptim me gojë apo paraqitje e një frikësimi të jashtëm pa argument e fakt bindës. Që të jetë teubeja e vërtetë dhe e singertë duhen veprime konkrete të dobishme



që burojnë nga thellësia e singeritetit dhe e forcës së besimit. “Nuk ka dyshim se Unë e fal atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqendrohet për në rrugën e drejtë” - (Ta Ha: 82).

Vepra e mirë nuk arrihet nëpërmjet një namazi të veçantë apo haxhi e zeqati specifik. Sjellja e mirë fshin gabimet, fshin mëkatet dhe rrit shkallët e devotshmërisë. Durimi ndaj vështirësive eliminon fajet, shumimi i thënies së istigfarit (kërkim faljeje nga Zoti Fuqplotë) e përmendja e Krijuesit të gjithësisë bën që Allahu (xh.sh) me dëshirën e Tij absolute të largojë të keqen nga njeriu dhe të afrojë tek ai të mirën me anë të së cilës i mundësohet pastrimi i zemrës nga ligësitë, ruajtja nga gjynahet e mëdha dhe afrimi me punë të vlefshme sa më tepër kënaqësisë së të Madhit Zot që padyshim është edhe qëllimi i krijimit tonë në këtë botë të përkohshme. Thotë Allahu (xh.sh) në Librin e shenjtë: “Dhe fale namazin në dy skajet e ditës, e edhe në orët e afërta (me ditën) të natës. S'ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat. Kjo është një këshillë për ata që pranojnë këshillat” - (Hudë: 114). Ndërsa transmetohet nga Ebu Dher'ri Muadh ibn Xhebeli (r.a) se profeti Muhamed (a.s) ka thënë: “Kije frikë Allahun kudo që të jesh, zëvendësoje të keqën me të mirë dhe sillu me njerëzit me edukatë të mirë”.

Adresa e besimtarit duhet të jetë përmendja e Allahut (xh.sh) dhe kërkimi falje vazhdimisht për çdo vepër të keqe, të vogël apo të madhe, me apo pa qëllim. Kjo do të thotë që njeriu nuk duhet për asnjë çast dhe asnjë rrethanë të harrojë Madhni absolute të Krijuesit. Kujtesa

e besimtarit duhet të jetë në lëvizje, në pushim, në zgjim, para fjetjes, gjatë angazhimit të çdo pune, gjatë gjendjes së lirë etj, pra të dijë se Zoti Fuqplotë është në vend mbikëqyrje vazhdimisht. Për këtë i dërguari i Allahut (xh.sh) ka thënë: “Besimi më i mirë (më i shkallëzuar) është që të dish se Allahu është me ty kudo që të gjendesh”. Për ta përforcuar këtë mendim sjellim fjalët e Allahut (xh.sh) që thotë: “E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të të cilëve kur përmendet Allahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. Dhe të cilët falin (rregullisht) namazin dhe nga ajo, me çka Ne i furnizuem, ata japin. Të tillët janë besimtarë të vërtetë dhe për këtë kanë vende të larta te Zoti i tyre, kanë falje dhe kanë furnizim në mënyrë të ndershme.” - (El-Enfalë: 2-4)

Përderisa një njeri është besimtar ai duhet të ketë sjellje të mirëfilltë islame, ngase vetëm kështu gjendet më afër ndihmës së Allahut (xh.sh) në çdo situatë, si në gëzim e në hidhërim, në vështirësi e në lehtësim, në paqe dhe në çdo rrethanë tjetër.

Prandaj le ta kujtojmë vazhdimisht Krijuesin tonë të pashoq, sepse e sotmja është veprim pa llogari, kurse e nesërmja është llogari pa veprim. Le t'i afrohem më tepër nënshtrimit të Allahut (xh.sh) dhe devotshmërisë ndaj Madhnisë së Tij, mbase do të jemi prej atyre që Allahu (xh.sh) ka thënë në Kur'anin Famëlartë: “Përveç atij që është penduar (ka bërë teube) dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë”...

VETËM VENDLINDJA E TYRE I KA HARRUAR...!?



Paraditen e sotme u përfshiva nga një lloj emocioni, që nuk ndodh të përjetohet çdo ditë. Studentët shqiptarë në Medine kishin publikuar fotot e një eventi kulturor, që mesa kuptova, po realizohej nga dita e sotme në qytetin e Resulull-llahut (a.s), në të Ndriçuarën Medine.

Një panair kulturor i përvitshëm, ku edhe Shqipëria kishte këndin e vet të spikatur. Studentët tanë të teologjisë me veshjet tradicionale kombëtare, në një ambient të zbukuruar me elementë të traditës tonë shqiptare.

Për një moment, ky panair ndërkombëtar, më kujtoi organizimet e ngjashme që bëheshin edhe në shkollën tonë në Siri, sidomos në ditë bajramesh, kur, me shumë dashamirësi na kërkohej që të visheshim me kostume kombëtare... Krijohej një atmosferë e mrekullueshme, që frymëzohej nga ajeti kur'anor 13 i sures El-Huxhurat: "O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu, më i fisni ndër ju, është ai që më tepër është ruajtur nga të këqijat e, All-llahu është i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë."

Kultura kombëtare, traditat dhe zakonet, tiparet dhe cilësitë, si elementë dallues në mesin e popujve. Një temë e gjerë, një ajet prej ajeteve të madhështisë së krijimit të njeriut!

Duke vëzhguar fotot e publikuara të Panairit Ndërkombëtar të Kulturave në Medine, u përlova, teksa, tek sektori

i Shqipërisë tonë të shtrenjtë, pashë këndin e dijetarëve dhe hoxhallarëve elitarë, si: Shejkh Shuajb Arnauti, Shejkh Abdulkadir Arnauti, Shejkh Nasirudin Albani, H. Vehbi Dibra, ishte edhe Hoxha (rahmet pastë), H. Vehbi S. Gavoçi me nurin e tij, Hafiz Sabri Koçi, Hafiz Ibrahim Dalliu, i madhi Hafiz Ali Korça etj.

Secili prej tyre ka specifikat dhe tiparet e tij, që e karakterizojnë, që e bëjnë të veçantë. Në mesin e tyre ka dijetarë elitarë, që i vlerëson mbarë ymeti islam; qindra miliona njerëz në mbarë globin. Krenohen me përmendjen e emrave të këtyre shqiptarëve të mëdhenj, nderohen me posedimin e veprave të tyre, rriten në besim e dije, duke lexuar e mësuar prej tyre... Nga Indonezia në Australi, nga Amerika në Indi, nga Gjermania në Katar, nga Çeçenia në Egjipt, nga Afrika e Jugut në Siri; kush nuk ia ka dëgjuar emrat e tyre? Subhanallah! Vetëm vendlindja e tyre i ka harruar...!?

Në mesin e tyre ka ligjërues elokuentë, hadithologë, fakihë, verifikues e studiuesesh detajesh të imëta shkencore, specialistë të akaidit, edukimit social, mufesirë të Kur'anit, poliglotë e eruditë të pashembullt...

Iu riktheva sërish sektorit të Shqipërisë. Kultura kombëtare, veshjet, orenditë dhe Dijetarët Hoxhallarë, që na bëjnë të ndjehemi kudo krenarë në botë!

Realisht, ajo që ndodh tek ne në Shqipëri, është përplasja qytetërimesh, kulturash e botëkuptimesh! Është përplasja shekullore, që gërren në mënyrë tinzare trungun e kombit!

Realisht është komplot kundër vlerave islame dhe traditave tona kombëtare me frymëzim islam, ai që ndodh në vendin tonë, në Shqipërinë e misionarëve të fshirjes së gjurmëve të ISLAMIT! Absolutisht, është përplasje e dhunshme, që ndodh në heshtje, por edhe ditën për diell, ditë për ditë, muaj për muaj, vit për vit! Mealesef!!!

Përndryshe, emri i H. Vehbi Dibrës, do të duhej të ishte i pari në listën e artë të parlamentit të Shqipërisë (natyrshëm, jo për çështje numrash e renditjesh; çështja është më e thellë se kaq!); Përndryshe, të paktën adresa e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë do të duhej të mbante emrin e Hafiz Sabri Koçit. Përndryshe, shtatorja e kryeparlamentarit të parë, Hafiz Xhemal Naipi, do të duhej të ishte aty, në hyrje të sheshit, a diku në lulishten e tij. Përndryshe, Presidenca duhet të kishte një titull nderi me emrin e ndonjërit prej tyre. Përndryshe, sheshe e rrugë kryesore të Shqipërisë do të duhej të mbanin emrat e tyre, por.., kjo nuk ndodh në Shqipërinë e laicizimit të neveritshëm selektiv!?

Ne, muslimanët e Shqipërisë jetojmë në një xhungël përplasje primitive, frikërash të imponuara e të stisura, mashtrimesh e nëpërkëmbjesh, padrejtësishë dhe shkelje të drejtash, që janë bërë zakon e natyrë, që fatkeqësisht na kanë verbuar, na kanë humbur ndjenjat, ndjesitë, ekuilibrin e të qëndruarit në këmbë!

Ka shumë rëndësi të fillojmë e të mendojmë për të gjetur mundësitë e ringritjes në këmbë dhe rifitimit të ekuilibrit! Përndryshe, flasim kot, mendojmë kot, bëjmë se veprojmë kot, vegjetojmë në një moçalishte të fëlliqtë provincializmi dhe inkuizicioni të imponuar nga shpirtshurit e kohëve moderne!

Ka shumë rëndësi të ndryshojmë qëndrimin e sjellje përballë këtij inkuizicioni të mëndafshët!

U riktheva tek Panairi Ndërkombëtar i Medines, ku Drita dhe Madhështia e hoxhallarëve të mëdhenj të vendit tim, i jepnin madhështi dhe vlerë. E bënë Shqipërinë të dallueshme nga krejt bota dhe, natyrshëm u ndjeva krenar, shumë krenar...

I falënderova me zemër studentët tanë dhe u luta për mbarësinë e tyre, për mbarësinë e Panairit të Medines...

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, më 29 mars 2016



H. Fejzi Zaganjori
imam - xhamia Rus

TË NDALIM DORËN E GJAKMARRJES DHE T'I JAPIM BESËN E PAJTIMIT DHE TË PAQES.

Myftinia e Shkodrës në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar, kërkon e do të kërkojë që të drejtat, që Allahu (xh.sh) ia ka dhënë njeriut, duhet të zbatohen nga çdokush, por njëherë duhet që edhe detyrat që ka njeriu t'i plotësojë. Krahas paqes që duhet të mbizotërojë në shpirtin e njeriut, padyshim, një nga të drejtat kryesore, që Allahu (xh.sh) ia ka dhënë njeriut, është e drejta e jetës. Jeta është dhunti nga Allahu (xh.sh) dhe këtë nuk ka të drejtë askush, jo të ia marri tjetrit, por as edhe ta cënojë aspak. Jeta është një amanet nga i Madhi Zot dhe njeriu është i besuari i Tij, i cili amanetin duhet ta trajtojë me nder me përkujdesjen e të Madhit Zot.

Myftinia e Shkodrës e mbështetur në urdhrat e dhëna nga Kur'ani i Madhërueshëm dhe nga porositë e Hz. Muhamedit (a.s) në mënyrë të vazhdueshme e trajton çështjen e mbrojtjes së jetës dhe të dashurisë ndërmjet njerëzve. Çdoherë Myftiu i Zonës së Shkodrës, Imam Muhamed Sytari lëshon mesazhe të qarta kundër urrejtjes, ngatërresave e të tjera si këto, larg vetëgjyqësisë, hakmarrjes, gjakmarrjes e vrasjeve.

Duhet falënderuar në mënyrë të vazhdueshme Allahu (xh.sh), që i ka motivuar besimtarët myslimanë drejt besimit, drejt shpresës dhe frikës, gjë për të cilën tregojnë edhe shifrat e gjakmarrjes dhe të vrasjeve, që janë në minimum.

Problemet e marrjes së jetës, gjakmarrja e vrasjet, kanë mbetur tek ata njerëz, që janë akoma larg besimit dhe janë në një injorancë të plotë. Hz. Muhammed Mustafaja (a.s) në fjalimin e Lamtumirës, ndër të tjera tha: "O njerëz, me të vërtetë jeta, gjaku juaj, nderi dhe pasuria janë të shenjta". E pra, të dashur dhe të nderuar lexues, kjo thënie para pesëmbëdhjetë shekujsh, mbetet aktuale dhe do të vazhdojë deri sa të jetë jeta mbi këtë sipërfaqe të tokës, deri sa të vendoset drejtësia dhe paqja, kur të dëshirojë Allahu (xh.sh).

Sikur të gjithë njerëzit ta dinin, ta

studionin dhe ta përvetësonin këtë thirrje monumentale, çdo gjë do të ishte në rrugën e mirësisë, begatisë, dashurisë, paqes dhe larg çdo burimi të së keqes.

Janë organizuar emisione televizive, tryeza të rrumbullakëta, takime të tjera nga ana e Myftinisë Shkodër, por njëherësh ajo ka qenë e gatshme që çdoherë të jetë prezent dhe aktive për të dhënë ndihmën për problemet e gjakmarrjes, për të paraqitur punën e frytshme të Islamit dhe të myslimanëve në këtë drejtim në shkallë rrethi dhe republike, pavarësisht se kush i organizon, pasi këtu kemi të bëjmë me jetën e njeriut.

Kështu para disa ditëve, në bibliotekën shkencore të Universitetit, u bë takimi me temë "Nuk ka paqe pa drejtësi, nuk ka drejtësi pa falje", e organizuar nga Operazione Colomba, fondacion kundër gjakmarrjes. Në këtë takim nga Myftinia e Shkodrës u bë një ekspozitë për punën e saj, për arritjet në ndalimin e gjakmarrjes dhe të konflikteve të tjera si dhe të pajtimeve të ndryshme.

Po ashtu iu bë e njohur auditorit dhe më gjerë, për projektet dhe programet e hartuara e për këtë qëllim. U kërkuar që të bëhen lutje për ndalimin e vrasjeve në mbarë botën, në luftërat që po zhvillohen në Lindjen e Mesme, të zhvillohen samite të vazhdueshme ndërkombëtare islamo-kristiane, që të bashkëpunojnë kultura oksidentale dhe orientale për t'i dhënë fund grindjeve, shkatërrimeve dhe të vendoset drejtësia dhe paqja.

Nga të pranishmit u vlerësua puna e Myftinisë së Shkodrës dhe të gjitha idetë dhe mendimet u morën në konsideratë.

Të gjithë njerëzit duhet të binden dhe t'i nënshtrohen vetëm të Madhit Zot dhe tek Ai të kërkojmë zgjidhjen e çdo çështjeje. Pa besim nuk ka progres, nuk ka mirësi e begati, nuk ka qetësi dhe paqe, prandaj besimi tek Krijuesi i gjithësisë do të na udhëzojë dhe do të na mundësojë lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Njeriu është krijesa më e përkryer e të Madhit Zot, është krijesa dualiste e përbërë prej shpirtit dhe trupit. Njeriu lind i lirë dhe si i tillë edhe paqja është pjesë përbërëse e tij.

Pyesim: Njeriu këtë paqe të dëshiruar për të gjithë jetën e tij, a e ka të siguar?

Fjala paqe është tema kryesore e jetës së sotme botërore, duke përfshirë edhe ne shqiptarët në përgjithësi dhe ne shkodranët në veçanti. Kërkesa e paqes bëhet duke e njohur dhe duke e zbatuar atë në çdo veprimtari të aktivitetit njerëzor.

Në kuptimin e vërtetë fjala paqe do të thotë: Që në sipërfaqen e tokës të mbizotërojë ligji, mirësia, drejtësia, dashuria, humaniteti e të tjera, të cilat i urdhëron i Madhi Zot, që është burimi i paqes. Atëherë, nëse do të dëshirojmë të jetojmë në paqe, pa akuza, grabitje, shkatërrime, korrupsion, hakmarrje dhe marrje jetë njerëzish e të tjera si këto dhe të reflektojmë paqen, duhet meditojmë t'i nënshtrohemi urdhrave të Krijuesit Fuqiplotë dhe porosive të Hz. Muhamedit (a.s).

Duke jetuar me paqen, duke edhe kultivuar dhe përhapur atë, ne shquajmë atë që është e drejtë, e vërtetë dhe luftojmë të keqen. Çdo formë e marrëdhënieve ndërnjerëzore, jashtë kuadrit të paqes, shkakton marrëdhënie jo të mira, jokorrekte, johumane, e vrasje që janë fenomene të hidhura.

Ç'ka mund të jetë më njerëzore që të duam paqen e të sigurojmë jetën e tjetrit, që të zvogëlojmë vuajtjet e mundimet, të plotësojmë nevojat dhe të mbrojmë integritetin njerëzor etj.

KONKURSI I 6-TË I KURSEVE TË XHAMIVE TË SHKODRËS



Paraditën e së shtunës, më 26 mars 2016, sektori i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, organizoi në Xhaminë e Madhe, në Fushë Çelë, konkursin e 6-të të përvitshëm me fëmijët e kurseve të xhamive të Shkodrës.

Sipas të dhënave të sektorit të arsimit, në këtë konkurs morën pjesë përfaqësues të 40 xhamive, ku konkuruan dy nxënës të mirë të tyre, duke nxjerrë në pah përgatitjen dhe punën e mësuesve të tyre, imamëve të nderuar të xhamive tona.

Aktiviteti u përshëndet nga teologu Arben Halluni, i cili theksoi se ky konkurs i përvitshëm ka një vlerë të madhe, për të nxjerrë në pah përgatitjen e nxënësve dhe vlerën e kurseve tona fetare për edukimin e brezit të ri me edukatën fetare dhe mësimet elementare të fesë; suret e Kur'anit, rregullat e namazit, kushtet e besimit dhe Islamit, normat edukative islame etj.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili ndoqi me kënaqësi zhvillimin e konkursit dhe ndau me imamët e pranishëm dhe nxënësit e tyre, emocionet e kësaj dite të begatë.

Për rreth tre orë, pjesëmarrësit përfituan nga ky aktivitet i larmishëm, që u pasurua edhe nga programi i bukur artistik me ilahi e recitime, organizuar nga nxënësit e kurseve tona, All-llahu i ruajtë dhe i dhashtë suksese e mbarësi.

Në përfundim të këtij aktiviteti u shpallën edhe fituesit e këtij konkursi: Xhamia e fshatit Shtoj i Vjetër, Xhamia e fshatit Golem dhe Xhamia e fshatit Milan-Rrasek, sikurse spikatën xhamitë: Bardhaj, Boks, Luarëz, Bahçallek etj.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë imamët pjesëmarrës, si dhe komisionin vlerësues të përbërë nga teologët: Idmir Plaku, Lavdrim Hamja dhe Adil Cukali.



“Dje ishim ymeti më i mirë,
sot u bëmë më i keqi ymet!?”

Dje ishim Fatihë (çlirimtarë),
sot u bëmë emigrantë..!?”

Dje zotëronim gjysmën
e botës, sot humbëm gjysmën
e popullit tonë nëpër botë!?”

Dje eksportonim dituri
dhe shkenca, sot eksportojmë
përçarje, urrejtje
dhe sektarizëm!?”

Dje qeverisnim me drejtësi
dhe mëshirë, sot arabët
vuajnë nga korrupsioni
dhe tirania!?”

Megjithatë, nuk do t'i
këndojmë të shkuarës,
nuk ka dobi prej kësaj,
por duhet të marrim mësim
nga e sotmja për të ndërtuar
një të ardhme të ndritshme!
Dhe, kjo nuk mund të arrihet
me lutje e dëshira,
por me punë të ndershme
dhe moral të lartë!”

Dr. Salahudin Keftaro

AKTIVITET ME VLERA NË KUJTIM TË HZ. MUHAMMEDIT (A.S)

Pasditën e së martës, më 12 prill 2016, Myftinia Shkodër, në bashkëpunim me Zyrën e Këshilltarit të Çështjeve të Fesë në Ambasadën e Turqisë, Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” dhe Shoqatën “Istanbul”, organizoi një konferencë fetare, në përkujtim të mesazhit hyjnor, me të cilin u dërgua Hz. Muhammedi (a.s).

Aktiviteti në fjalë, kishte si temë kryesore të tij unitetin dhe vëllazërinë islame në mesazhin e Hz. Muhamedit (a.s).

I ftuar special i këtij tubimi vlerash, ishte Dr. Omer Menekshe, autor i disa veprave fetare në gjuhën turke, njëkohësisht Drejtor i Zyrës së Komunikacionit në Dijanetin e Turqisë.

Njëkohësisht, aktiviteti u zbukurua me këndimin e mrekullueshëm të disa pjesëve kur’anore nga Hafiz Adem Kemaneci, imam i Xhamisë Presidenciale në Ankara.

Në referatin e tij para të pranishëmve të shumtë, Dr. Menekshe



vuri theksin te nevoja e madhe që ka sot ymeti islam për unitet dhe vëllazëri. Ai tha se e sotmja e muslimanëve në botë është dhimbje e lot, që duhen ndryshuar nëpërmjet rrugëve të harmonisë, vëllazërisë dhe unitetit në mesazhet e Hz. MUHAMMEDIT (a.s).

Dr. Omer Menekshe theksoi se në Islam, kombet dhe racat nuk janë pengesë e unitetit, kur prin besimi dhe udhëheqja në jetë sipas porosive dhe

botëkuptimit islam.

Më herët, përshëndetën edhe z. Jasin Shengyl, përfaqësues i Zyrës së Këshilltarit të Çështjeve Fetare, Imam Muhamed B. Sytari Myfti i Zonës Shkodër dhe z. Xhem Bash, Konsull i Turqisë.

Pjesë e aktivitetit ishte edhe një ilahi e bukur e kënduar nga medresisti Orhan Dani që dhuroi emocione të veçanta.

Ditën e martë, më 12 prill 2016, menaxheri i pronave në Myftininë e Shkodrës, z. Blendi Alushi, i shoqëruar edhe nga teologu Lavdrim Hamja, zhvilloi një inspektim paraprak, për të parë nga afër gjendjen e punimeve për xhaminë e re në Krye-Bushat.

Xhamia e re, që po ndërtohet në vakëfin e vjetër të kësaj zone, është pjesë e bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Fondacionin “Mirësia”.

Xhamia e re, ishte kërkesë e vazhdueshme e besimtarëve muslimanë të pesë lagjeve të Krye-Bushatit, si dhe një nevojë e kahershme e tyre për kryerjen e adhurimeve ditore, mësimin e fëmijëve dhe edukimin e rinisë me edukatën dhe kulturën islame.

Me mbarësinë e All-llahut, punimet vazhdojnë rregullisht dhe pritët që brenda këtij viti, xhamia e re të hapë

INSPEKTOHEN PUNIMET E XHAMISË SË RE NË KRYE-BUSHAT



dyert e saj për frekuentuesit e saj.

Myftinia Shkodër falënderon bashkëpunimin me Fondacionin “Mirësia” dhe ftoj besimtarët të

luten në vazhdimësi për mbrojtjen e vakëfeve të shenjta, zhvillimin dhe shfrytëzimin e tyre në dobi të komunitetit.

PRESIDENTI ERDOGAN BËN HAPJEN E QENDRËS KULTURORE DHE TL QYTETËRIMIT TURKO-AMERIKAN NË SHBA



Më 5 prill 2016, presidenti i Turqisë, z. Rexhep Tajib Erdogan, bëri inaugurimin dhe hapjen e Qendrës Kulturore dhe të Qytetërimit Turko-Amerikan (Qendra Fetare Amerikane) në Maryland të SHBA-ve.

Presidenti Erdogan në fjalimin e tij tha se “Gjithmonë e kam shprehur, terrorizmi kategorikisht nuk ka fé, kombësi, racë apo rrënjë. Terroristi është një person i cili e meriton këtë emër për shkak të krimeve që ka kryer kundër njerëzimit. Është e papranueshme që dhimbjen dhe tmerrin që shkaktuan një grup terroristësh ndaj SHBA-ve më 11 shtator t'i faturohet të gjithë myslimanëve”.

Ai duke shprehur falënderimet për kontribuuesit në këtë vepër tha: “Kjo xhami me kapacitet prej 750 personash, e cila është ndërtuar sipas arkitekturës osmane, na jep ndjenjën sikur të jemi në Turqi. Qendra Kulturore dhe e Qytetërimit Turko-Amerikan është një kompleks, e cila krahas xhamisë ka edhe

bibliotekë, ambient për mysafirë, sallë sporti dhe ambiente të tjera sociale. Kjo qendër krahas ambienteve për adhurim është projektuar dhe zbatuar për të përballuar të gjitha nevojat në fushën sociale. Ky investim i realizuar në rajonin Maryland padyshim që do t'u shërbejë edhe myslimanëve amerikanë në rajonet përreth”, deklaroi Erdogan.

Presidenti turk në ceremoninë e hapjes së Qendrës Kulturore dhe të Qytetërimit Turko-Amerikan (Qendra Fetare Amerikane) në Maryland ka shprehur urimet më të mira duke uruar që kjo xhami të jetë në shërbim të të gjithë myslimanëve.

Erdogan pas fjalimit ka bërë hapjen e kësaj qendre duke prerë shiritin e kuq së bashku me kryetarin e Çështjeve Fetare (Diyanet) të Turqisë, prof.dr. Mehmet Gormez. Ndërsa më pas presidenti Erdogan ka hyrë në xhami dhe duke marrë informacion, ka vizituar edhe ambientet e tjera në Qendrën Kulturore.

(radiojehona.al)



*Pejgamberi (a.s)
ka thënë:*

*“Besimtari i fortë
është më i mirë
dhe më i dashur tek Allahu
se sa besimtari i dobët,
megjithëse tek të dy
ka mirësi. Kujdesu për atë
që të bën dobi,
kërkoi ndihmë Allahut
dhe mos përto. Po qe se
të godet diçka, mos thuaj:
Sikur të kisha vepruar
do të kishte qenë kështu
e ashta, por thuaj:
Ishte përcaktimi i Zotit,
atë që ka dashur ka bërë,
sepse “sikur”
hap derën shejtanit.”*

(Transmetuar nga Muslimi)

Paraditën e së mërkurës, më 13 prill 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt një përfaqësi specialistësh të Bankës Islame për Zhvillim, me qendër në Xhiddah të Arabisë Saudite, nën drejtimin e Dr. Muhammed Ahmed Salim, specialist i zhvillimit urban dhe përgjegjës i projekteve vakëf.

Përfaqësuesit e Bankës Islame për Zhvillim, shoqëroheshin në këtë vizitë pune nga z. Uran Kalej, Drejtor i Vakëf-Investimeve në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Gjatë këtij takimi u diskutua për disa projekte të Myftinisë Shkodër në drejtim të zhvillimit të vakëfeve të ndryshme në Shkodër.

Myftiu bëri një prezantim të zhvillimeve të fundit në Shkodër dhe trajtimin e vakëfeve të muslimanëve në vendin tonë, sidomos pas vitit 1990.

Gjatë këtij takimi u vlerësua fryma e

VIZITË PUNE E SPECIALISTËVE TË BANKËS ISLAME PËR ZHVILLIM



bashkëpunimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me Bankën Isame për Zhvillim, si dhe domosdoshmëria e rritjes së këtij bashkëpunimi në drejtim të zhvillimit të pronave vakëf në vendin

tonë. U vizituan disa vakëfe të qytetit, si dhe Medreseja “Haxhi Sheh Shamia”, dega djem, godina e së cilës është ndërtuar nga Banka Islame për Zhvillim.

AKTIVITET SENSIBILILUES: “TË RUAJMË AMBIENTIN!”

Paraditën e ditës së shtunë, më 16 prill 2016, Myftinia Shkodër nëpërmjet sektorit të arsimit organizoi një aktivitet sensibilizues dhe ndërgjegjësuës me moton: “Të ruajmë ambientin”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin nxënës të kurseve fetare të xhamive: Kullaj, Fshati i Ri dhe Milan. Të drejtuar nga mësuesit e tyre fetarë, Ardin Selhani, Indrit Plangaj dhe Fitim Karmaj ata gjatë disa orëve arritën me pasion të pastrojnë ambientet e urës së vjetër monumentale të Mesit, mjediset e shkollës publike, etj, duke dhënë shembullin e një qytetari që e do dhe e ruan ambientin dhe ndërkohë tërheqë vëmendjen për të mos e dëmtuar apo shëmtuar këtë dhunti natyrore të



dhuruar nga Zoti Fuqiplotë.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm teologët Arben Halluni dhe Lavdrim Hamja. Drejtuesi i Arsimit, pranë

Myftinisë Shkodër, z. Halluni gjatë një bisedë me nxënësit theksoj se: “Është detyrë e jona qytetare, por edhe fetare që ta ruajmë mjedisin, sikurse ruajmë shtëpitë tona. Mjedisi është vatra jonë, frymëmarrja jonë e përditshme, e fëmijëve tanë, e familjes dhe e gjithë shoqërisë shqiptare dhe më gjerë. Mjedisi mund të jetojë pa ne, por ne nuk mund të jetojmë pa mjedisin. Paqe me njerëzit, paqe me natyrën...”, -tha ndër të tjera teologu Halluni.

Një projekt i tillë sensibilizues nga ana e Myftinisë Shkodër do të vazhdojë edhe në të ardhmen në zona të tjera të rrethit të Shkodrës.





المحبة الإسلامية الألبانية
دار الإفتاء - مدينة شكوذرا
KOMUNITETI MYSLIMAN I SHKODËR
MYFTINIA SHKODËR



HAFIZ MUSA DËRGUTI
(1888-1961)

“Më kërkojnë me folë për priftën,
dojnë me na përça, e nesër me thanë
se u pushkatuen priftënt
me dëshmitë e hoxhallarëve.
U kam thanë bani çka të doni,
se atë punë s’e baj kurrë!”

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org